




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova / Republic Of Kosovo**  
**Komuna Shtime**  
**Opstina Štimlje / Municipality Of Shtime**



Drejtoria për Zhvillim Ekonomik  
/ Direktorat za Ekonomski Razvoj / Directorate for Economic Development

Nr.04/08  
Data, 22.02.2019

Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, në Nenin 8 Pika 5 dhe Pika 6 e këtij ligji precizon Përgjegjësit e Komunës për njoftimin publik për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim; Rregullorja QRK nr. 23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës; Vendimin e Kuvendit të Komunës Nr. 01-060/01-2051/19/28 të datës 31.01.2019 për miratim paraprak të pronës së paluajtshme komunale; Vendimin e Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Komunale Nr. 01-060/01-21899/18-203 të datës 03.08.2018 për Autorizimin e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik që të udhëheq procedurat e konkursit;

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, shpall:

**NJOFTIM PUBLIK**  
**PËR DHËNIEN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM**

<b>1</b>	<b>Emërtimi, madhësia, lokacioni, përshkrimi dhe pronësia e parcelave</b>	<p>Pronat e miratuara nga kuvendi për dhënie në shfrytëzim janë:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>Parcelë. Certifikata për të drejtën e pronësisë, nr. P-72809023 në pronësi të Kuvendit Komunal. Parcela kadastrale nr. 00333-2 me sipërfaqe 11290m<sup>2</sup>. Lokacioni Davidoc te vendi i quajtur utrin. Parcela është kullos e klasës së parë.</li><li>Pjesë e Parcelës. Certifikata për të drejtën e pronësisë, nr. P-72809023 në pronësi të Kuvendit Komunal. Pjesë e parcelës kadastrale nr. 00333-3 me sipërfaqe 2170 m<sup>2</sup>. Lokacioni Davidoc te vendi i quajtur utrin. Parcela është kullos e klasës së parë</li><li>Pjesë e Parcelës. Certifikata për të drejtën e pronësisë, nr. P-72809027 në pronësi të Kuvendit Komunal. Pjesë e parcelës kadastrale nr. 00267-0, me sipërfaqe 849m<sup>2</sup>. Lokacioni Godanc i Poshtëm te vendi i quajtur utrin. Parcela është kullos e klasës së tretë dhe tokë ndërtimore.</li></ol>
----------	---	---

2	<b>Kohëzgjatja e shfrytëzimit dhe kufizimet për aplikim</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Dhënie në shfrytëzim, deri në afat prej 99 vjet (nëntëdhjetenëntë), me kompensim për shfrytëzim, me pëlqim të pronarit dhe në pajtim me ligjin në fuqi.</li> <li>- Konkurrimi lejohet për një, disa apo të gjitha parcelat.</li> </ul>
3	<b>Çfarëdo kushti apo kufizimi mbi dhënien e të drejtave për shfrytëzim</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Fillimi i aktiviteteve brenda 6 muajve</li> <li>- Punësimi sipas planit të biznesit</li> <li>- Investime sipas planit të biznesit</li> <li>- Shfrytëzuesi nuk ka drejtë në asnjë mënyrë që ngastrën kadastrale të marrë në shfrytëzim ta bart te personi i tretë me nën qira apo në çfarëdo mënyre tjetër në të kundërtën, themeluesi e ka të drejtën e shkëputjes së njëanshme të kontratës pa paralajmërim.</li> <li>- Shfrytëzuesi nuk ka drejtë në asnjë mënyrë që ngastrën kadastrale të marrë në shfrytëzim ta len në hipotekë në të kundërtën, themeluesi e ka të drejtën e shkëputjes së njëanshme të kontratës pa paralajmërim.</li> <li>- Shfrytëzuesi nuk ka të drejtë ta ndërroj veprimtarin e biznesit me të cilën ka aplikuar në të kundërtën, themeluesi e ka të drejtën e shkëputjes së njëanshme të kontratës pa paralajmërim.</li> </ul>
4	<b>Veprimtarit që nuk lejohen të ushtrohen në këto parcela</b>	<p>Në parcelat e ofruara për shfrytëzim nuk lejohen të zhvillohen veprimtari afariste si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Lojëra të fatit; Autoserviset; Ferma të kafshëve dhe shpezëve; Vend për tregtimin e kafshëve; Veprimtari të stacioneve të karburanteve dhe gasit; Prodhimin e gëlqeres; Pajisjet për shfrytëzimin e fuqisë së erës për prodhimin e energjisë; Sharra për lëndë drunore; Mbledhja dhe grumbullimi i mbeturinave ku magazinohen mbeturina interne (plastik, letër, dhe qelq);</li> </ul>
5	<b>Formën e konkurrencës</b>	Konkurrim me hapje publike të ofertave
6	<b>Çmimi fillestar</b>	<p>15€ ari për vit (nga data e nënshkrimit të kontratës, pagesa hyn në fuqi).</p> <p>Çmimi fillestar është kusht për kualifikim.</p>
7	<b>Kërkesat për pjesëmarrje në konkurrim</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Certifikata e regjistrimit të biznesit</li> <li>- Veprimtarin e biznesit</li> <li>- Historianin e biznesit</li> <li>- Plani i biznesit i cili duhet të përmbajë: Fillimi i aktiviteteve brenda 6 muajve, numrin e punëtorëve, vlerën e investimit dhe llojin e veprimtarisë që do ta ushtroj.</li> <li>- Deklaratë në emrin e aplikuesit në të cilën deklaron ofertën për qiranë vjetore për ari (jo më pak se 20€).</li> <li>- Vërtetimin e shlyerjes së obligimeve të tatimit në pronë.</li> <li>- Vërtetimin e shlyerjes së obligimeve ndaj ATK-së (nuk vlen për bizneset fillestar)</li> <li>- Dëshmi nga ATK për numrin aktual të punësuarve</li> <li>- Të gjitha dokumentet duhet të jenë në një zarf të mbyllur</li> </ul>

8	<b>Procedurat e regjistrimit të ofertuesve</b>	Ofertuesit mund të aplikojnë nga data e publikimit për 45 ditë kalendarike. Aplikacioni merret në zyrën nr. 39, në objektin e komunës (kati i dytë). Po ashtu konkursin mund ta gjeni në web-faqen zyrtare: <a href="http://kk.rks-gov.net/shtime">http://kk.rks-gov.net/shtime</a> në linkun Shpalljet - Konkurset ku edhe mund ta shkarkoni.
9	<b>Afati i fundit për aplikim</b>	Afati i fundit për aplikim është me datë 08.04.2019.
10	<b>Koha dhe Vendi ku mbahet hapja e ofertave</b>	Hapja e ofertave mbahet më datën 11.04.2019 në ora 10:00, Ndërtesa e Kuvendit të Komunës, Kati përdhes, Salla Nr. 01

#### Dokumentet e nevojshme për konkurrim:

- Certifikata e regjistrimit të biznesit
- Veprimtarin e biznesit
- Historianin e biznesit
- Plani i biznesit i cili duhet të përmbajë: Fillimi i aktiviteteve brenda 6 muajve, numrin e punëtorëve, vlerën e investimit dhe llojin e veprimtarisë që do ta ushtroj.
- Deklaratë në emrin e aplikuesit në të cilën deklaron ofertën për qiranë vjetore për ari (jo më pak se 15€).
- Vërtetimin e shlyerjes së obligimeve të tatimit në pronë.
- Vërtetimin e shlyerjes së obligimeve ndaj ATK-së (nuk vlen për bizneset fillestar)
- Dëshmi nga ATK për numrin aktual të punësuarve

#### Kriteret për zgjedhjen e ofertave:

- Oferta ekonomikisht më e favorshme
- Vlera e investimit
- Numri i të punësuarve nga investimi
- Lloji i investimit që është interes publik për komunën
- Përfitimi financiar i komunës
- Kriteret të tjera që janë të parapara në konkurs.

#### Pjesëmarrëseve në konkurrim u garantohet e drejta që:

- Informohen lidhur me procedurat e konkursit publik
- Të shohin pronën që do të jetë objekt i dhënies në shfrytëzim
- Të kenë qasje në dokumentacionin e pronës



Drejtori, Fitim Hoxha

Adresa: Rr. "Tahir Sinani" Nr. 50, 72000, Shtime, Republika e Kosovës.

Tel.: +381290389016, Ext.: 227, Mob.: 044 733 362

Email: fitim.hoxha@rks-gov.net